



Sundimi i Demokracisë në Kosovë



## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

Për

Implementimin e Projektit:

**“Angazhimi qytetar dhe institucional në mbrojtjen dhe ruajtjen e ujrave”**

Memorandumi është shprehje e vullnetit të dyanshëm në mes të Organizatës Sundimi i Demokracisë në Kosovë - SDK dhe Komunës së Shtimes për Implementimin e Projektit: *“Angazhimi qytetar dhe institucional në mbrojtjen dhe ruajtjen e ujrave”*

**Ky Memorandum i Mirëkuptimit lidhet ndërmjet:**

1. **Organizatës Sundimi i Demokracisë në Kosovë – SDK Orllan/Podujevë**
2. **Komuna e Shtimes**


### Neni 1

#### Burimi i Projektit

1.1 Projekti **“Angazhimi qytetar dhe institucional në mbrojtjen dhe ruajtjen e ujrave”**, është grant që përkrahët nga Integrated Water Resources Management in Kosovo IWRM-K.



Sundimi i Demokracisë në Kosovë



## **Neni 2**

### **Qëllimi**

- 2.1 Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është themelimi i bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Shtimes me OJQ – SDK, me qëllim që të bëhet sa më i lehtë implementimi i projektit të cekura në nenin 1.
- 2.2 Përmes këtij Memorandumi Komuna e Shtimes mirëkupton qëllimin e Projektit në fjalë, dhe shprehë vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me Organizatën SDK në përmbushjen e qëllimit të projektit.

## **Neni 3**


### **Obligimet e palëve**

- 3.1 SDK, do të bashkëpunoj ngusht me Kryetarin e Komunës për të inicuar formimin e Grupit Punues për hartimin e një strategjie e cila do të ketë në fokus trajtimin e ujrave nga niveli lokal. Grupi punues do të jetë gjithpërfshirës, i përbërë nga sektorë të ndryshëm të komunës (sektori mjedisit, urbanizmit, buxhetit dhe të tjerë), do të ketë edhe përfshirje të shoqërisë civile.
- 3.2 SDK, do të ofroj ndihmë teknike për komunën e Shtimes në zhvillim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Do të angazhoj një ekspert të fushës së ujrave në mënyrë që të ndihmohj komunën në identifikimin e nevojave dhe hapave që duhet të ndërmerren për zhvillimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Eksperti do të jetë i angazhuar në kohëzgjatje prej 10 muajve dhe do të kompenzohet nga organizata SDK.
- 3.3 SDK, në bashkëpunim me Komunën e Shtimes, në veçanti me Grupin Punues të themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës, do të organizojnë tre takime/tryeza diskutimi në mënyrë që të mbledhën të dhëna sa më shumë nga akter të ndryshëm që ndërlidhën me fushën e mbrojtjes së ujrave.
- 3.4 Grupi Punues do të jetë bashkëpunues me Ekspertin e angazhuar nga organizata SDK, i cili edhe do të udhëheq punëtoritë/takimet me Grupin Punues dhe do të jetë përgjegjës për draftimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- 3.5 SDK, në bashkëpunim me Komunën e Shtimes do të organizojnë një dëgjim publike për draftin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, të cilat do t'i prezantohen publikut, me qëllim të mbledhjes së të dhënave, sugjerimeve dhe rekomandimeve që duhet të merrën parasyshë gjatë finalizimit të draftit.
- 3.6 Komuna e Shtimes, do të lejoj qasje SDK-së për mbajtjen e disa leksioneve me nxënës, me qëllim të vetëdijesimit të tyre për rëndësinë dhe mbrojtjen e ujrave që posedon vendi ynë (do të mbahen 2 takime të tilla)
- 3.7 SDK, në bashkëpunim me Komunën e Shtimes do të organizojnë një takim me fermer, me qëllim të diskutimit të alternativave të mundshme të shfrytëzimit të ujit për ujitje, si dhe të shfrytëzimit sa më racional të ujrave.

## **Neni 4**



Sundimi i Demokracisë në Kosovë



### **Përgjegjësitë e Palëve**

- 4.1 Komuna e Shtimes nuk mbanë përgjegjësi rreth implementimit të këtij Projekti, përveç bashkëpunimit të shprehura nga Neni 2 i këtij Memorandumi.
- 4.2 OJQ SDK është përgjegjëse që gjatë implementimit të Projektit mos të shkaktohen situata që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nivelit lokal.

### **Neni 5**

#### **Implementimi dhe Amendamenti**

- 5.1 Implementimin e këtij Memorandumi do të e monitorojnë - Organizata SDK dhe Komuna e Shtimes.
- 5.2 Ky Memorandum i Mirëkuptimit mund të ndryshohet apo plotësohet sipas marrëveshjeve të arritura me shkrim midis palëve.
- 5.3 Ndryshimet dhe plotësimet bëhen pjesë përbërse e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

### **Neni 6**

#### **Dispozitat Kohore**

- 6.1 Periudha implementuese e këtij Projekti është 12 muaj, duke filluar nga 1 Mars 2023 deri më 28 Shkurt 2024.

### **Neni 7**

#### **Hyrja në fuqi**

- 6.2 Ky Memorandum i Mirëkuptimit është hartuar në dy (2) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.
- 6.3 Memorandumi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese dhe vlen deri në realizimin e të gjitha aktiviteteve të parapara me projekt.

### **Palët nënshkruese**

**OJQ SDK**

**Rexhep Zeka**  
Drejtore Ekzekutive



**Komuna Shtime**

**Qemajl Aliu**  
Kryetar i Komunës

Shtime, 15/03 2023